

Historiku i krijimit të DIM, FIMIF

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike është ndër fakultetet më të rinj të Universitetit Politeknik të Tiranës, që sot kremton 10 vjetorin e tij. Përpyqjet për krijimin e këtij fakulteti datojnë më 04.10.2004 me Urdhërin e Rektorit të UPT-së, Prof. Dr. Përparim HOXHA, Nr. 83 Prot., për “*Ngritjen e Grupit të punës për riorganizimin e Departamenteve pranë Rektoratit në përputhje me objektivat e reformimit të Universitetit sipas parimeve të procesit të Bolonjës*”. Në përbërje të grupit të punës u zgjodhën anëtarë të departamenteve pranë Rektoratit, përkatësisht të Departamentit të Matematikës dhe Informatikës, Departamentit të Fizikës dhe Departamentit të Kimisë.

Grupi i punës, bazuar në përvojën e Universiteteve Politeknike të vendeve të ndryshme të botës, veçanërisht të Universitetit Politeknik të Milanos dhe Torinos, propozoi hapjen e dy diplomave të reja ndërdisiplinore, përkatësisht:

Inxhinieri Matematike, pranë Departamentit të Matematikës dhe Informatikës dhe ***Inxhinieri Fizike***, pranë Departamentit të Fizikës,

propozim i cili u miratua nga Senati i UPT-së, në **Vendimin Nr. 17**, datë **04.05.2005**.

Pas miratimit, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Z. Luan MEMUSHI, në shkresën me Nr. **5354** Prot., e **5355**, datë **22.08.2005**, i Vendimit Nr. 17, datë 04.05.2005, të Senatit të UPT-së, **filloi për herë të parë**, në Universitetin Politeknik të Tiranës, **në vitin akademik 2005-2006**, përkatësisht pranë:

- ***Departamentit të Matematikës dhe Informatikës***, me 32 pedagogë të brendshëm dhe 26 të jashtëm, *Kursi i Studimeve të Ciklit të Parë*, me kohëzgjatje 3-vjeçare, ***Inxhinieri Matematike***, me 31 studentë;
- ***Departamentit të Fizikës***, me 16 pedagogë të brendshëm dhe 32 të jashtëm, *Kursi i Studimeve të Ciklit të Parë*, me kohëzgjatje 3-vjeçare, ***Inxhinieri Fizike***, me 30 studentë.

Senati i UPT-së, me **Vendimin Nr. 6**, datë **03.03.2006**, miratoi:

Hapjen e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në Universitetin Politeknik të Tiranës.

me mision:

- Të përgatisë në këto dy fusha inxhinierë cilësorë, të aftë për t'u integruar në tregun specifik të punës (të brendshëm dhe të jashtëm);

- Të mbulojë ngarkesën mësimore në të gjitha disiplinat matematike dhe fizike për Universitetin Politenik.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 824**, datë **05.12.2007**, “Për Krijimin e disa njësive kryesore, fakultete në Universitetin Politeknik të Tiranës”, miratohet:

Krijimi i Fakultetit të Formimit të Përgjithshëm, si fakultet i asociuar,

i cili të ketë në përbërje:

1. *Departamentin e Fizikës dhe Kimisë;*
2. *Departamentin e Matematikës;*
3. *Qendrën e Gjuhëve të Huaja.*

Duke konsideruar diplomat e *Inxhinierisë Matematike* dhe *Inxhinierisë Fizike* si diploma ndërdisiplinore.

Statusi dhe emërtimi i Fakultetit të Formimit të Përgjithshëm ndryshoi me daljen e **Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 345**, datë **08.04.2009** për “Disa ndryshime në Vendimin Nr. 824, datë 05.12.2007, të Këshillit të Ministrave, për krijimin e disa njësive kryesore, fakultete, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, ku miratohet:

Krijimi i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

që ka në përbërje:

- i. Departamentin e Inxhinierisë Matematike;***
- ii. Departamentin e Inxhinierisë Fizike;***
- iii. Departamentin e Kimisë;***
- iv. Qendrën e Gjuhëve të Huaja***

me dy diploma në *Inxhinieri Matematike* dhe *Inxhinieri Fizike*.

Bazuar në VKM-në, **Nr. 910**, datë **26.08.2009**, “Për hapjen e programeve të Studimit të Ciklit të Dytë, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, nisi **në vitin akademik 2009-2010** rrugëtimi i programeve të Studimit të Ciklit të Dytë:

- ***Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike***, me 21 studentë

- **Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike**, me 18 studentë.

Në zbatim të Urdhërit, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Z. Myqerem Tafaj, **Nr. 605**, datë **29.12.2010**, “Për hapjen e programeve të Studimit të Ciklit të Tretë, të Doktoraturës në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës”, filluan në vitin akademik **2010-2011**, Programet e Studimit të Ciklit të Tretë, të hartuara sipas Ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”:

- **Doktoraturë në Inxhinieri Matematike** (në dy drejtime; *Analizë Numerike dhe Ekuacione diferenciale / Kërkime Operacionale dhe Statistikë*), me 17 studentë.
- **Doktoraturë Inxhinieri Fizike** (në dy drejtime; *Optikë e zbatuar / Fizika e Materialeve*), me 11 studentë.

Studimet e Ciklit të tretë synonin përgatitjen e mëtjshme nga ana shkencore në fushën e Analizës numerike dhe Ekuacioneve Diferenciale, të Kërkimeve Operacionale dhe Statistikë, si dhe në fushën e Optikës së Zbatuar dhe të Fizikës së Materialeve.

Duke patur parasysh nevojat e reja të tregut të punës si dhe mungesën e profesionistëve, të aftë të përballen me koncepte bashkëkohore, si dhe me zgjidhjen e problemeve që lidhen me:

- *menaxhimin e sistemeve komplekse;*
- *trajtimet klinike dhe kontrollin e cilësisë së pajisjeve mjekësore;*
- *analizimin e pasojave financiare të riskut, nëpërmjet matematikës, statistikës dhe teorive financiare*

u hartuan programet e Studimit të Ciklit të Dytë **Master Profesionale në:**

- **Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh**
- **Inxhinieri Fizike në Mjekësi**
- **Inxhinieri Matematike Profili Aktuaristikë**

Bazuar në Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Z. Myqerem Tafaj, **Nr. 597**, datë **09.12.2011**, “Për hapjen e programeve të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional, të Universitetit Politeknik të Tiranës”, filloi në vitin akademik **2012-2013**, Programet e Studimit të Ciklit të Dytë, të hartuara sipas Ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”:

- **Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh** me 14 studentë
- **Master Profesional në Inxhinieri Fizike në Mjekësi** me 12 studentë.

Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Z. Lindita Nikolla, **Nr. 274**, datë **20.07.2015**, “Për hapjen e programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Inxhinieri Matematike me Profil Aktuaristikë, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, filloi në vitin akademik **2015-2016**, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë,

- **Master Profesional në Inxhinieri Matematike Profili Aktuaristikë** me 28 studentë.

Gjatë këtyre viteve stafi akademik ka punuar me përkushtim për transmetimin tek studentët të një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter të theksuar praktik, duke realizuar ciklin *informacion-njohuri-dije-aftësi*. Krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve të rëndësishme në FIM&IF është kërkimi shkencor në përputhje me filozofinë dhe misionin e UPT-së, në përputhje me interesat e universitetit, të stafit akademik dhe të studentëve. Synimi kryesor i veprimtarisë kërkimore shkencore është përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së procesit mësimor, si edhe ngritjes së vazhdueshme të standardeve akademike në FIM&IF. Mbështetur në objektivat dhe qëllimet e veprimtarisë kërkimore shkencore, si dhe në parimin e lirisë së ushtrimit të veprimtarisë shkencore dhe mësimdhënies akademike, personeli akademik i FIM&IF ka realizuar një punë hulumtuese sistematike për kërkimin dhe zhvillimin e njohurive të reja, shfrytëzimin dhe zbatimin e tyre në praktikë. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar edhe transferimit të dijeve nëpërmjet publikimit të rezultateve në revista shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca kombëtar dhe ndërkombëtare. Publikimi i rezultateve të punës kërkimore në revistave shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, të vlerësuara nga stafi akademik si nxitje e debatit shkencor jo vetëm mes komunitetit akademik të fakultetit, por edhe dhe atij shqiptar e të huaj, është shoqëruar gjatë këtyre 10 viteve, me një numër të kënaqshëm prezantimesh dhe botimesh cilësore, duke ndikuar në kualifikimin e vazhdueshmë shkencor të personelit akademik.

Veprimtaria mësimore dhe kërkimore në fakultet është realizuar si nëpërmjet bashkëpunimit me Institucionet e Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale dhe komunitetin e biznesit, ashtu edhe nëpërmjet projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, midis të cilave

veçojmë:

➤ **Projektet:**

- “Ndertimi i Modelit parashikues te aksidenteve rrugore ne rajonin Tirane-Durres bazuar ne metoda probabilitare e statistikore dhe krijimi i një sistemi GIS per vizualimin e rezultateve te projektit”

Konferenca

Kujdes i veçantë është treguar edhe për organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare:

- *Studime të avancuara në Inxhinierinë Matematike, Fizike dhe Kimike*, 28 tetor 2011;
- *New Technologies and Applications in Medicine / Teknologjitë e reja dhe aplikimet në mjekësi*, 7 nëntor 2014;
- *The 2nd International Conference on Applied Sciences and Engineering 2017, ICEAS 2017 / Konferenca e Dytë Ndërkombëtare në Shkencat e Aplikuara dhe Inxhinierike 2017*, më 16-17 nëntor 2017.

Ecuria e DIM gjatë këtyre 10 viteve është drejtuar nga përgjegjësat e departamenteve:

▪ **Përgjegjës i Departamentit të Matematikës / Inxhinierisë Matematike:**

Prof. Dr. Shpëtim LEKA	2008 – 2009
Prof. Asc. Ligor NIKOLLA	2009 – 2014
Dr: Adrian NAÇO	2014 - 2016
Prof. Asc. Shkëlqim KUKA	2016 në vazhdim

Personeli akademik që ka kontribuar DIM,

Prof. Dr. Shpëtim LEKA



Në 1971 përfundoi kursin e Matematikës 5- vjecare në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës

Fusha kërkimore shkencore ku ka dhënë dhe kontributin kryesor: “Shpërndarjet Asimptotike të Statistikave”.

Ka qënë dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, anetar i grupin kerkimor: “Teoria e Probabiliteteve dhe Statistika Matematike”.

Ka qënë iniciator dhe ka dhënë kontribut në krijimin e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inzhinierisë Fizike prane UPT. Ka ndihmuar në konsolidimin e Departamentit të Inxhinierisë Matematike nga pikëpamja organizative, shkencore e metodike. Ka ndihmuar ne hartimin e programeve bashkëkohore.

Prof. Asoc. Ligor NIKOLLA

Diplomuar me 1980 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Dega Matematikë 5-vjeçar. Aktualisht Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike. Anëtare në grupin kërkimor “Analizë Matematike”
Fusha kërkimore shkencore:

- Analize Numerike, Analize Matematike

Referime në konferenca dhe botime:

- Analiza Spektrale dhe Filtrat Numerik
- Vetite Spektrale te Operatorëve të Shrodingerit
- Metodot e Valëzës



Prof. Dr. Jorgo MALITA

Diplomuar ne Matematikë 1961 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

Ka qënë kryetar i grupit shkencor të “Analizë Matematike”. Ka shkruar tekste universitare të cilët kanë shërbyer për vite me radhë në të gjithë degët inxhinierike të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Shumë breza studentesh e kujtojnë me respekt per mjeshtërine që e karakterizonte në mësimdhënie si dhe kthjelltësinë e mendimit.

Ka hartuar shumë programe studimi për të gjitha degët e Universitetit Politeknik të Tiranës.



Prof. Dr. Vladimir JORGJI



Diplomuar ne Matematikë 1965 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.
Ka qënë përgjegjës i grupit kërkimor “Analizë Matematike”
Fusha kërkimore shkencore: “Analize Matematike”, “Algjebër dhe Gjeometri”
Ka qënë autor dhe bashkëautor në disa referime dhe botime shkencore.
Ka shkruar tekste Universitare si “Trigonometria sferike” dhe “Matematika 4” për Degën e Gjeodezisë

Prof. Dr. Avdyl HAXHIMUSAI

Diplomuar në Matematikë 1964 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

Ka qënë anëtar i Departamentit të matematikës dhe njëkohësisht përgjegjës i këtij departamenti.

Ka qënë pjesmarrës në shumë konferenca brenda dhe jashtë vendit.

Ka qënë autor e bashkëautor i disa teksteve universitare të cilat iu kanë dhënë formimin bazë, brezave të inxhinierëve.

Ka ndihmuar në hartimin e programeve mësimore dhe kryesisht në lëndën “Algjebër Gjeometri”



Prof. Dr. Kristaq FILIPI

Diplomuar në Matematikë 1966 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

Ka qënë përgjegjës i grupit kërkimor të “Algjebërës & Gjometrisë”
Fusha kërkimore shkencore:

- Algjebër: Modulet, radikalet dhe nilradikalet relative
- Aplikime të Matematikës në Tekstil

Ka shumë referime dhe botime në konferenca dhe revista kombëtare e ndërkombëtare
Tekste Universitare:

- Algjebra dhe Gjeometria (Për bachelor në Inxhinieri),
- Matematikë e Aplikuar në Tekstil (Niveli i masterit shkencor për studentët e Inxhinierisë.





Prof. Dr. Viktor KABILI

Diplomuar në Matematikë 1962 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

Ka qënë përgjegjës i grupit kërkimor “Analizë Matematike”
Fusha kërkimore shkencore: “Analizë Matematike”, “Algjebër dhe Gjeometri”.

Autor dhe bashkëautor në disa referime dhe botime shkencore.

Ka shkruar Tekste Universitare per degët inxhinierike te Universitetit Politeknik të Tiranës.

Prof. Dr. Shpëtim BOZDO

Diplomuar në Matematikë 1966 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

Ka qënë anëtar i grupit kërkimor “Analizë Matematike”
Fusha kërkimore shkencore: “Analizë Matematike”, “Algjebër dhe Gjeometri”

Autor dhe bashkëautor në disa referime dhe botime shkencore.

Ka shkruar Tekste Universitare si “Analizë Matematike” e “Aplikime të Matematikës në Ekonomi



Prof. Dr. Margarita QIRKO

Diplomuar më 1975 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Dega Matematikë 5-vjeçar.

Ka qënë përgjegjese në grupin kërkimor “Analiza Numerike” .

Fusha kërkimore shkencore: “Analizë Numerike”

Ka disa referime dhe botime në konferenca dhe revista shkencore.

Eshtë autore e shumë programeve mesimore te lendes Analize Numerike. Gjithashtu

eshte e autore e teksteve universitare si “Analiza Numerike”, etj.

Prof. Asoc. Luigj GJOKA

Diplomuar më 1972 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Dega Matematikë 5-vjeçar.

Ka qene anetare ne grupin kerkimor “Analize Matematike”
Fusha kerkimore shkencore: “Analizë Matematike dhe Ekuacione Diferenciale“

Ka hartuar disa programe per te nivelin “Master Profesional” ne Inxhinierine Matematike.

Tekste Universitare:

“Funksione Speciale Dhe Zbatime Të Tyre”, “Ekuacione Të Fizikës Matematike”, “Analiza Matematike 1”, “Analiza Matematike 2”



Prof. Dr. Shpëtim SHEHU

Diplomuar më 1971 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Dega Matematikë 5-vjeçar.

Ka qënë përgjegjës i grupit kërkimor “Teoria e Probabiliteteve dhe Statistika Matematike

Fusha kërkimore shkencore: “Modelimi Statistikor i Teorisë së Rradhëve” dhe “Analiza Statistikore e problemeve të mësimesh në arsimin universitar”. Eshtë autor i shumë

programeve mesimore dhe teksteve Universitare: “Analiza Matematike dhe Algebra Lineare”, “Ushtrime të teorisë së Probabilitetit dhe Statistikës Matematike”, “Teoria e Probabiliteteve dhe Statistikës Matematike”, “Kërkime Operazionale “.



Prof. Dr. Agron TATO

Diplomuar më 1972 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Dega Matematikë 5-vjeçar.

Ka qënë anëtar i grupit kërkimor “Analizë Matematike”

Fusha kërkimore shkencore: “Analizë Matematike”,
Autor dhe bashkëautor në disa referime dhe botime shkencore ndërkombëtare

Ka ndihmuar në hartimin e programeve mesimore në nivelin “Master Shkencor”. Eshte autor i disa teksteve universitare.

Prof. Dr. Lulëzim HANELLI

Diplomuar më 1980 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Dega Matematikë 5-vjeçar.

Përgjegjës i grupit kërkimor “Analiza Numerike”

Fusha kërkimore shkencore: “Analizë Numerike dhe kompjuterike”

Ka disa referime dhe botime në konferenca dhe revista shkencore.

Ka hartuar programe mësimore për të tria nivelet e studimit, Bachelor, Master Shkencor, Master Profesional.

Tekste Universitare:

- “Analiza numerike me Matlab”, për studentët e deges së Inxhinierisë Matematike
 - “Analiza numerike në Ekuacionet me Derivate të pjesshme”, për studentët e degës së Inxhinierisë Matematike
-



Prof. Asoc. Akli FUNDO

Diplomuar në 1991 Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Dega “Matematikë” - 5 vjeçar.

Aktualisht mban pozicionin e zv/ Rektorit të Universitetit Politeknik Tiranës.

Përgjegjës i grupit kërkimor shkencor “Analiza Matematike”.

Fitues çmimesh në disa Olimpiada të Matematikës Specializime të ndryshme në Universitete perëndimore.

Autor i librave të ndryshëm universitarë si “Analiza Matematike”.

Autor i artikujve shkencorë.



Prof. Asoc. Shkëlqim KUKA

Diplomuar në 1987 në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Dega “Matematikë” - 5 vjeçar.

Aktualisht mban pozicionin e Përgjegjësit të Departamentit të Inxhinierisë Matematike.

Përgjegjës i grupit kërkimor “Algjebër-Gjeometri”

Fusha kërkimore shkencore:

- Algjebër
- Sistemet e Informacionit Gjeografik.
- Aplikime të matematikës në fusha të ndryshme të inxhinierisë civile.

Autor i disa referimeve dhe artikujve në revista shkencorë.

Autor i librave universitarë si “Algjebra Lineare dhe Gjeometria Analitike”





Dr. Adrian NAÇO

Diplomuar në 1998 në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Dega “Matematikë” - 5 vjecar. Anëtar në grupet kërkimor “Analiza Numerike”, “Algjebër e Gjeometri”. Fusha kërkimore shkencore:

- Metoda numerike për zgjidhjen e ekuacioneve diferenciale
- Problemi vlerës kufitare në Ekuacionet Diferenciale të Zakonshme

Specializime të ndryshme në Universitete perëndimore. Autor i librave universitarë si “Algebra Lineare dhe Gjeometria Analitike”, etj. Ka qenë përgjegjës i Departamentit të Inxhinierisë Matematike gjatë viteve 2014-2016.

**Aktivite të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike
konferenca / projekte / aktivitete me studentë**

Konferenca

- Konferenca e 1 Kombëtare “*Studime të Avancuara në Inxhinierinë Matematike, Fizike dhe Kimike*”, 28.10 2011
- Konferenca 2 ndërkombetare : *The 2nd International Conference on Applied Sciences and Engineering 2017*, ICEAS 2017, November 16 - 17, 2017. Albania



Seminare

- Departamenti i Inxhinierisë Matematike në bashkëpunim me Proff. Jorge Jimenez Urroz (Universidad Politecnica de Catalunya (UPC), Barcelona, SPAIN) zhvilloi cikël leksionesh nga data **20 deri 25 Qershor 2016**

Në program u përfshinë temat:

- 1) Elementary arithmetics
 - 2) groups, rings, fields morphisms.
 - 3) The ring of polynomials
 - 4) Finite fields. Properties and explicit construction of finite fields.
 - 5) Application to coding and cryptography
- Departamenti i Inxhinierisë Matematike në Bashkëpunim me Prof. Dr. Petros Groupos

(University of Patra Department of Electrical and Computer Engineering GREECE) zhvilloi cikël leksionesh në datën 15/11/2017 me temë: “Fuzzy Cognitive Maps in Biostatistics, econometrics, modeling and simulation”

Konferenca

- *New Technologies and Applications in Medicine / Teknologjitë e Reja dhe Aplikimet në Mjekësi, 7 nëntor 2014*



Projekti me studentët : **Të njohim profesionin**

Studentë të vitit të III Inxhinieri Matematike vizitojnë “meteoalb” për të parë se si përdoren metodat numerike në parashikimin e motit

Studentet paraqisin punimet e tyre






Vizitë mësimore, të studentëve në fabrikën e
“Birra Korça”

Ceremoni Diplomimi në FIM&IF




Studentët e regjistruar në FIM&IF

Numri i studentëve që janë regjistruar në programet e studimit të *Ciklit të Parë* dhe të *Ciklit të Dytë*, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike sipas viteve akademike.




Studentët e diplomuar në FIM&IF

Numri i studentëve të diplomuar, që kanë përfunduar studimet e *Ciklit të Parë* dhe të *Ciklit të Dytë*, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike sipas viteve akademike



Studentët e regjistruar në Ciklin e Tretë, në FIM&IF

Numri i studentëve që janë regjistruar në programet e studimit të *Ciklit të Tretë, Doktoraturë në Inxhinieri Matematike dhe Doktoraturë në Inxhinieri Fizike*, në FIM&IF, sipas viteve akademike, është si më poshtë:



Studentët e diplomuar në në Ciklin e Tretë, në FIM&IF

Numri i studentëve të diplomuar, pra që kanë përfunduar studimet e *Ciklit të Tretë, Doktoraturë Inxhinieri Matematike dhe Doktoraturë në Inxhinieri Fizike* në FIM&IF sipas viteve akademike, është si më poshtë:

